

I/E nderuar z/zj. ,

ju ftojmë të kryeni një kontroll mjekësor që shërben në parandalimin e kancerit të zorrës së trashë (kancerit kolorektal).

Ky kontroll mjekësor bën të mundur zbulimin e pranisë të gjurmëve të gjakut të fshehtë, jo të dukshëm me sy të lirë, që shpesh mund të jetë shenja e parë e sëmundjes.

Është një kontroll mjekësor falas, i thjeshtë dhe i shpejtë për burrat dhe gratë midis moshës nga 50 deri në 74 vjeç, për të cilin nuk është e nevojshme kërkesa e mjekut të familjes.

Ja se si duhet vepruar:

- Mblidhni një sasi të vogël jashtëqitjeje në një provëz (enë e veçantë) sipas udhëzimeve;
- Shkruani në provëz emrin, mbiemrin dhe datën e lindjes;
- Ruani provëzën me jashtëqitjet në frigorifer;
- Plotësoni pyetësin që ndodhet në zarf;
- Në jo më shumë se dy ditë, dorëzoni kampionin (provëzën me jashtëqitjet) dhe pyetësin e plotësuar, në qendrat e analizave më të afërta (lista e qendrave të analizave është e bashkangjitur me këtë letër)

Dorëzimi i kampionit mund të bëhet edhe nga një njeri i besuar.

Nëse është e nevojshme, nëpërmjet një certifikate, mund të justifikojmë mungesën nga puna.

Letra e ftesës dhe materialet e bashkangjitura janë dërguar në Dosjen Shëndetsore Elektronike tuajën (nëse e keni aktivizuar), mjekut të familjes dhe me postë të zakonshme në vendbanimin tuaj.

Do ju dërgojmë një letër me rezultatet e analizës ose do ju kontaktojmë me telefon për një takim.

Për më shumë d:

- Mund të flisni me mjekun e familjes
- Mund të telefononi në numrin pa pagesë 800-300315
- Mund të na shkruani në: infocolonretto@ausl.mo.it
- Mund të shikoni në faqen e internetit dedikuar programit : www.ausl.mo.it/screeningcolonretto

Kujdesuni për shëndetin tuaj, bashkohuni ftesës!

Me respekt

Menaxheri i programit

Firma e përgjegjësit